



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 02 nëntor 2020
Nr. Ref.:RK 1635/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI12/20

Parashtrues

Hamijete Dinarama-Daija

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të
Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që
lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit,
AC-I-13-0181-A0008, të 29 gushtit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Hamijete Dinarama-Daija, me banim në Gjakovë (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesja e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Aktgjykimin [AC-I-13-0181-A0008] e 29 gushtit 2019 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit i DHPGJS-së).
3. Aktgjykimin [AC-I-13-0181-A0008] e 29 gushtit 2019 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, parashtruesja e kërkesës e pranoi më 4 shtator 2019.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, përmes të cilit parashtruesja e kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të saj të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrojtja e Pronës) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenin 22 [Procedimi i kërkesës] dhe nenin 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 01/2018 (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 15 janar 2020, parashtruesja e kërkesës përmes postës e dorëzoi kërkesën e saj në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 27 janar 2020, Kryetarja e Gjykatës në rastin KI11/20, caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Bajram Ljatifi (anëtarë).
8. Më 27 janar 2020, në pajtim me rregullin 40 (1) (Bashkimi dhe ndarja e kërkesave) të Rregullores së punës, Kryetarja e Gjykatës urdhëroi bashkimin e kërkesës KI12/20 me kërkesën KI11/20.
9. Më 5 shkurt 2020, Gjykata njoftoi parashtrueset e kërkesave në rastet KI11/20 dhe KI12/20, për regjistrimin dhe bashkimin e kërkesave.
10. Të njëjtën ditë, Gjykata njoftoi DHPGJS-në për regjistrimin e kërkesave dhe bashkimin e tyre.

11. Më 10 qershor 2020, Gjykata kërkoi nga DHPGJS, që të dorëzojë në Gjykatë fletëkthesat që dëshmojnë se kur parashtrueset e kërkesës e kanë pranuar Aktgjykimin [AC-I-13-0181-A0008] e 29 gushtit 2019, të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së.
12. Më 12 qershor 2020, DHPGJS dorëzoi në Gjykatë dokumentet e kërkuara.
13. Më 8 shtator 2020, Gjykata në përputhje me rregullin 40 (3) të Rregullores së punës vendosi që kërkesat KI11/20 dhe KI12/20 të shqyrtohen ndaras, në raste individuale, me gjyqtarin raportues dhe Kolegjin shqyrtues të njëjtë.
14. Më 9 shtator 2020, Gjykata njoftoi parashtrueset e kërkesave në rastet KI11/20 dhe KI12/20 dhe DHPGJS-në për ndarjen e kërkesave.
15. Më 14 tetor 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

16. Më 15 shtator 2010, Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP) kishte privatizuar ndërmarrjen shoqërore NSH "Agimi" në Gjakovë, ku parashtruesja e kërkesës ishte punëtore e ndërmarrjes në një periudhë të caktuar kohore.
17. Më 22 dhjetor 2011, përmes mjeteve të informimit publik u publikua Lista Përfundimtare e punëtorëve me të drejta legjitime për të marrë pjesë nga të ardhurat e 20%-it nga privatizimi i NSH "Agimi", Gjakovë (në tekstin e mëtejme: Lista Përfundimtare), si dhe u përcaktua 14 janari 2012 si datë e fundit e dorëzimit të ankesave në DHPGJS kundër Listës Përfundimtare.
18. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesja e kërkesës kishte parashtruar ankesë në AKP, për shkak të mospërfshirjes në Listën Përfundimtare.
19. Më 13 dhjetor 2011, AKP përmes Vendimit refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruar nga parashtruesja e kërkesës.
20. Më 13 janar 2012, parashtruesja e kërkesës parashtrroi ankesë në Kolegjin e Specializuar të DHPGJS-së, për shkak të mospërfshirjes në Listën Përfundimtare.
21. Më 13 prill 2012, AKP paraqiti përgjigje në ankesë, duke pretenduar se parashtruesja e kërkesës nuk kishte ofruar prova të mjaftueshme përmes të cilave do të vërtetohej kontinuiteti i marrëdhënies së punës dhe duke theksuar se në kohën e privatizimit, parashtruesja e kërkesës nuk ishte e regjistruar si punëtore në NSH "Agimi".
22. Më 4 shtator 2013, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së nxori Aktgjykimin [SCel-11-0075] përmes të cilit vendosi se: "[...]; *III. refuzohen si të pabazuara. [...], ankesat e ankuesve "[...] 5. Hamijete Dinarama-Daija (C 0017)]*".

23. Kolegji i Specializuar në pikën III. të Aktgjykimit [SCEL-11-0075] e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtrueses së kërkesës, duke arsyetuar se parashtruesja e kërkesës nuk kishte dorëzuar asnjë dëshmi për shqyrtim dhe administrim siç parashihej me paragrafin 4 të nenit 10 (Të drejtat e të punësuarve) të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/45, që përcakton se punëtorët që konsiderohen legjitim për pjesëmarrje në 20% të fitimit të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore duhet të dëshmojnë se: (i) janë punëtorë të regjistruar të ndërmarrjes shoqërore përkatëse në kohën e privatizimit; dhe se (ii) kanë qenë në listën e pagave të ndërmarrjes shoqërore për jo më pak se 3 (tre) vjet.
24. Më 26 shtator 2013, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së nxori Aktvendimin [SCEL-11-0075] përmes të cilit korrigjoi versionin në gjuhën angleze të Aktgjykimit [SCEL-11-0075] të 4 shtatorit 2013, pasi që me rastin e përcjelljes së një kopje të aktgjykimit në versionin në gjuhën angleze, në vend që t'iu përcillet aktgjykimi përfundimtar, palëve u ishte përcjellë aktgjykimi preliminar ndërsa versionin në gjuhën shqipe mbeti i pandryshuar.
25. Më 5 nëntor 2013, parashtruesja e kërkesës kishte parashtruar ankesë në Kolegjin e Apelit kundër Aktgjykimit [SCEL-11-0075] të Kolegjit të Specializuar të 4 shtatorit 2013, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.
26. Më 29 gusht 2019, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së nxori Aktgjykimin [AC-I-13-0181-A0008], përmes së cilit vendosi që "[...] 2. *Ankesat e ankuesve, [...], A0009 Hamijete Dinarama*", refuzohen si të pabazuara.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

27. Parashtruesja e kërkesës pretendon se me Aktgjykimin [AC-I-13-0181-A0008] e 29 gushtit 2019 të Kolegjit të Apelit, i janë shkelur të drejtat e saj të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, si dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrojtja e Pronës) të KEDNJ-së.
28. Parashtruesja e kërkesës e ndërton rastin e saj kryesisht mbi pretendimin për shkeljen e të drejtës së saj për gjykim të drejtë dhe të paanshëm pasi që Aktgjykimi [AC-I-13-0181-A0008] i 29 gushtit 2019, i Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së nuk i ka plotësuar kriteret për një "*gjykim të drejtë*" sipas nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së për shkak të: (i) mungesës së arsytimit të vendimit gjyqësor; (ii) mosmbajtjes së seancës publike për shqyrtimin e pretendimeve të tyre dhe (iii) cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm.
29. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu thekson se është shkelur edhe parimi kushtetues i paraparë me nenin 24 të Kushtetutës - Barazia para Ligjit, për shkak të interpretimit të *diskriminimit* të dhënë nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së. Lidhur me pretendimin për diskriminim, parashtruesja e kërkesës thekson se

diskriminimi konsiston në faktin se punëtorët me të drejta legjitime janë larguar nga Lista Përfundimtare e punëtorëve me të drejta për përfitim nga shitja e NSH "Agimi" Gjakovë dhe jo në baza etnike siç kishte arsyetuar Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme. Rrjedhimisht, sipas saj, është cenuar garancia kushtetuese e përcaktuar në nenin 24 të Kushtetutës, sipas së cilës të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe çdokush gëzon mbrojtje pa diskriminim.

30. Parashtruesja e kërkesës krejt në fund pretendon se i janë shkelur të drejtat e përcaktuara me nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, pa dhënë ndonjë elaborim më të detajuar.
31. Përfundimisht, parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata: (i) *t'i deklarojë kërkesat të pranueshme*; (ii) *të konstatojë se ka pasur shkelje të neneve 24, 31 dhe 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së*; (iii) *ta shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin [AC-I-13-0181-A0008] e 29 gushtit 2019 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, dhe të njëjtin ta kthejë për rigjykim në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate.*

Pranueshmëria e kërkesës

32. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të specifikuara më tej me Ligj dhe të përcaktuara me Rregullore të punës.
33. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

34. Gjykata gjithashtu vlerëson nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç specifikohet më tej në Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 i Ligjit
[Kërkesa individuale]

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individidi mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Neni 48 i Ligjit
[Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Neni 49 i Ligjit
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor ...".

35. Në fillim, Gjykata i referohet datës së dorëzimit të vendimit përfundimtar dhe datës së parashtrimi të kërkesës në Gjykatë për të vlerësuar nëse parashtruesja e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të caktuar prej 4 (katër) muajsh.
36. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton që vendimi i fundit në rastin e parashtrueses së kërkesës është Aktgjykimi [AC-I-13-0181-A0008] i Kolegjit të Apelit, i 29 gushtit 2019.
37. Në bazë të fletëkthesës, të cilën DHPGJS në përgjigjen e saj të 10 qershorit 2020 e ka dorëzuar në Gjykatë, kjo e fundit vëren se parashtruesja vendimin e kontestuar e ka pranuar më 4 shtator 2019.
38. Gjykata rikujton se periudha prej 4 (katër) muajsh fillon të ecë që nga data në të cilën parashtruesi i kërkesës dhe/ose përfaqësuesi i tij apo i saj ka pranuar vendimin përfundimtar apo ka pasur dijeni të mjaftueshme për vendimin përfundimtar të gjykatave të rregullta (shih Vendimin e GJEDNJ-së *Koç dhe Tosun kundër Turqisë*, nr. 23852/04, të 13 nëntorit 2008).
39. Më tej, Gjykata vëren se dorëzimi i vendimit përfundimtar të gjykatave të rregullta, i cili i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës, shërben më së miri gjatë llogaritjes së periudhës prej 4 (katër) katër muajsh e cila fillon të ecë nga data e dorëzimit të kopjes së vendimit (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Worm kundër Austrisë*, nr. (83/1996/702/894), të 29 gushtit 1997, paragrafi 33).
40. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se parashtruesja e kërkesës vendimin e kontestuar e ka pranuar më 4 shtator 2019, ndërsa kërkesën në Gjykatë e ka dorëzuar përmes postës më 15 janar 2020, që do të thotë se kërkesa e parashtrueses së kërkesës është dorëzuar jashtë afatit të përcaktuar ligjor.
41. Gjykata përsërit se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë sigurinë juridike, duke siguruar që rastet që ngrenë çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme dhe të parandalojë që autoritetet dhe palët e tjera të interesuara të mbahen në gjendje të pasigurisë për një

periudhë më të gjatë kohore (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Mocanu dhe të tjerët kundër Rumanisë*, kërkesat nr. (10865/09, 45886/07 dhe 32431/08), të 17 shtatorit 2014, paragrafi 258, shih, gjithashtu Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Lopes de Sousa Fernandes kundër Portugalisë*, nr. 56080/13, të 19 dhjetorit 2017, paragrafi 129).

42. Ky afat gjithashtu i mundëson parashtruesit potencial të kërkesës që të shqyrtojë nëse dëshiron të paraqes kërkesë dhe, nëse dëshiron, të vendosë për ankesat dhe argumentet konkrete që duhet ngritur dhe në të njëjtën kohë lehtëson vërtetimin e fakteve në këtë rast, meqë me kalimin e kohës, çdo shqyrtim i drejtë i çështjeve të ngritura bëhet problematik (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Sabri Güneş kundër Turqisë*, kërkesa nr. 27396/06, të 29 qershorit 2012, paragrafi 39).
43. Ky rregull specifikon afatin kohor për kontrollin e ushtruar nga Gjykata dhe paralajmëron individët dhe autoritetet shtetërore për afatin pas të cilit kontrolli i tillë nuk është më i mundur (shih Vendimin e GJEDNJ-së *Walker kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 34979/97, të 25 janarit 2000, shih, gjithashtu, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Sabri Güneş kundër Turqisë*, të cituar më lart, paragrafi 40).
44. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtrueses kërkesës nuk është parashtruar brenda afatit ligjor të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtrueses së kërkesës është e papranueshme, sepse është parashtruar jashtë afatit të paraparë ligjor.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, në nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, më 14 tetor 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Radomir Laban



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi